



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/ The Agriculture Development Agency

Dt. 23.05.2015

REF: 07/4

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, dt. 21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të Rregullores nr. 02/2011 për kushtet e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe në pajtim me nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, nenit 15 paragrafi 3 Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27 Korrik 2009), Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015 për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2015, të dt.02.03.2015, si dhe sipas kërkesës së aplikuesit, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë, merr:

VENDIM

Për refuzim të përkrahjes së projekteve për Bujqësi dhe Zhvillimit Rural

Emri dhe Mbiemri: Burim Aliu	
Numri Personal: [REDACTED]	Telefoni: [REDACTED]
Fshati: Terllabuq	Komuna: Vushtrri

I. I REFUZOHET mbështetja financiare për përkrahje në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015 për nënmasën 101.4.a Sektori Prodhimi i qumështit nga lopët , pasi që aplikuesi nuk i plotëson kushtet siç përcakton **Neni 5** të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015 për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2015, të dt.02.03.2015.

Arsyetim

Duke u bazuar në kërkesën e parashtruar nga aplikuesi, **Burim Aliu** nga **Terllabuq** , Komuna **Vushtrri** , me të cilën ka kërkuar përkrahje për mbështetje në Bujqësi dhe Zhvillim Rural përkatësisht në nënmasën

101.4.a Sektori Prodhimi i qumështit nga lopët

Gjatë kontrollës administrative të dokumentacionit të aplikuesit **Burim Aliu** është konstatuar se aplikuesi nuk e kalon prapun e pranueshmërisë së aplikacioneve duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ dhe Udhëzuesin për Aplikant. Në aplikacion mungojnë dokumentet në vijim:

1. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015, Neni 5, Paragrafi 2, Nënparagrafi 2.4, Pika 2.4.9, thot: Për projektet e ndertimit aplikantët në rastin e aplikimit duhet të dorzojnë : Pika 2.4.9.5, thot: Pelqimin urbanistik të komunes që deshmon se në rast të dhënjes së grantit përfituesi do të marr leje ndertimin. Aplikuesi nuk e ka sjell pelqimin urbanistik; Andaj duke marrë parasysh këto pika AZHB-ja merr vendim për refuzim.

Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015 për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2015, të dt.02.03.2015.

II. Obligohet Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë për zbatimin e këtij vendimi.

III. Ky Vendim hynë në fuqi ditën nënshkrimit të tij.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë për rishqyrtimin e tij në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij në MBPZHR.

T'i dërgohet: Fermerit-ës, Kompanisë, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Arkivit.

Prishtinë, më 23.05.2015

